



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:007603

Datë: 22.02.2021

Numri i dokumentit: 01528234

PKR. nr. 10/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Krimeve të Rënda, gjyqtari Nikollë Komani, kryetar i trupit gjykues, me sekretaren juridike Mandushe Doli, në lëndën penale kundër të akuzuarit J. P. nga fshati . . ., Komuna Rahovec, për shkak të veprës penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/I-nr. 16/2021 të datës 22.01.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë 15.02.2020, në prezencën e prokurores Ardita Beqiraj-Hyseni, të akuzuarit J. P., me datë 18.02.2021, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë **22.02.2021** përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **J. P.**, i biri i M. dhe N., e gjinisë B., data e lindjes . . . fshatin . . ., Komuna Rahovec, me vendqëndrim të përkohshëm në Zvicër, ka të kryer shkollën mesme, i martuar, atë i një fëmije, punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal . . .

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë 28.12.2019 në fshatin . . ., Komuna Rahovec, përdorë armën në kundërshtim me Ligjin e zbatueshëm lidhur me Armët të Republikës së Kosovës, në atë mënyrë që në shenjë gëzimi me rastin e martesës së vëllait, në oborrin e shtëpisë së tij, shtënë dy herë në ajër me armën e tij të llojit pistoletë me gaz, me numër serik EU-1050624, e të cilin rast i njëjti e tregon me rastin e marrjes në pyetje për armëmbajtje, me ç’ rast arma së bashku me një karikator i sekuestrohen.

- **me çka ka kryer veprë penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së.**

ËSHTË FAJTOR

Sepse nga koha e pacaktuar e deri me datë 03.01.2021 në fshatin . . . , Komuna Rahovec, pa autorizim ka poseduar armë në kundërshtim me nenin 4 par. 1 nën par. 1.1 të Ligjit për Armët të Republikës së Kosovës, të cilat me ligj kategorizohen si armë të ndaluara, në atë mënyrë që pasi më parë kishte postuar në rrjetin social facebook një fotografi me armë në dorë duke qëndruar në tarracën e ballkonit të shtëpisë së tij, si dhe pas identifikimit të tij nga ana e zyrtarëve policor, i njëjti në shtëpinë e tij menjëherë ka dorëzuar armën e tipit pistoletë me gaz e kal. 9 mm, me numër serik EU-1050624, e dëmtuar pa kafkë, me një karikator të cilën e kishte mbajtur të fshehur në kulmin e objektit të banjës-wc, në oborrin e shtëpisë së tij, e cila armë më pas është sekuestruar nga policia.

- **me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.**

Gjykata në bazë të nenit 6, 7, 17, 38, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71 par. 1 nën par. 1.2 dhe 1.3, 72 par. 1 nën par. 1.5, 367 par. 1, 366 par.1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP-së, e:

G j y k o n

Për veprën penale të përshkruar në dispozitivin e I-rë, **Dënim** me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej një (1) viti, nuk kryen vepër tjetër penale, ndërsa për veprën penale të përshkruar në dispozitivin e II-të, **Dënim** me gjobë në shumën prej gjashtëqind (600) €, të cilin dënim është i detyruar ta paguaj në afatin prej një (1) muaji nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tridhjetë (30) ditëve, duke ia llogaritur njëzet (20,00) € për një ditë burgimi.

Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej pesëdhjetë (50,00) €, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej pesëdhjetë (50,00) €, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konfiskohet pistoletë me gaz, kalibër 9 mm, me numër serik EU-1050624, me një karikator, si objekt i kryerjes së këtyre veprave penale.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktakuzën PP/I-nr. 16/2021 të datës 22.01.2021, ka akuzuar J. P. nga fshati . . . , Komuna Rahovec, për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Prokurorja Ardita Beqiraj-Hyseni pas leximit të aktakuzës dhe pasi i akuzuari e ka pranuar në tërësi fajësinë për dy veprat penale, ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë së bërë nga ana e të akuzuarit, meqenëse ky pranim i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat ndodhen në shkresat e lëndës, andaj i ka propozuar gjykatës që ky pranim i fajësisë të aprovohet.

I akuzuari J. P. ka deklaruar se e ka të qartë aktakuzën, nuk kërkon sqarime shtesë. Ka shtuar se të gjitha ato të cilat i ka lexuar prokurorja janë të sakta dhe duke u deklaruar lidhur me fajësinë ka theksuar se e pranon në tërësi fajësinë për dy veprat penale sipas aktakuzës.

Pasi që gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë për veprat penale që i vihen në barrë dhe është bindur se pranimin e fajësisë e ka bërë në baza vullnetare, gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë ka mbështetje edhe në provat e bashkëngjitura aktakuzës si raporti i oficerit policor i datës 03.01.2021, lista e armëve të sekuestruara e datës 03.01.2021, procesverbali mbi kontrollin e personit dhe banesës i datës 03.01.2021, foto-albumi, ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 248 par. 4 të KPP-së, ka bërë pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe shqyrtimin e ka vazhduar me shqyrtimin e dënimit.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin dhe llojit të tij, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Përpos konstatimit të kryerjes së veprave penale në mënyrën, kohën dhe vendin si në dispozitiva të këtij aktgjykimi nuk ka gjetur rrethana rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese ka marrë parasysh pranimin e fajësisë nga i akuzuari, sjelljen korrekte gjatë shqyrtimit fillestar, jodenueshmërinë e tij të mëparshme, e cilat rrethana lehtësuese kanë ndikuar që gjykata ti aplikoi dispozitat e zbutjes së dënimit për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së, ashtu që bazuar në nenin 71 par. 1 nën par. 1.2 dhe 1.3, 72 par. 1 nën par. 1.5 lidhur me nenin 49 par. 2 të KPRK-së, ku është e përcaktuar se mund ti shqiptohet dënim i kushtëzuar edhe për vepra penale ku me ligj është e paraparë dënim me burgim deri në dhjetë (10) vjet, nëse zbatohen dispozitat e zbutjes së dënimit, ashtu që bazuar në këto rrethana lehtësuese, ka zbatuar dispozitat e zbutjes së dënimit e të akuzuarin për veprën penale të përshkrua në pikën e I-rë, të dispozitivit e ka gjykuar me dënim nën minimumin e përcaktuar ligjor dhe atë me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej një (1) viti nuk kryen vepër tjetër penale, ndërsa për veprën penale në pikën e II-të, të dispozitivit dënim me gjobë në shumën prej gjashtëqind (600) €, me bindjen e plotë se këto dënime janë në harmoni me peshën e veprave penale, shkallën e përgjegjësisë dhe personalitetin e të akuzuarit dhe se gjykata është e bindur se me dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 dhe 47 të KPRK-së.

Vendimi për konfiskimin e revoles me numër serik EU-1050624, një karikator është marrë bazuar në nenin 366 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 50,00 €, është marrë bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-së, si dhe bazuar në nenin 39 par. 3 nën par. 3.2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit numër 05/L-036, është marrë vendimi për kompensimin e viktimave të krimit në shumën prej 50,00 €.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
PKR. nr. 10/21, datë 18.02.2021

Sekretarja juridike
Mandushe Doli

Kryetari i trupit gjykues,
Nikollë Komani

Udhëzim juridik: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.